VENDIM
Nr. 18, datë 31.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" SHPK, NR. 276, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 37, DATË 18.3.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 24/2 prot., datë 24.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93 prot., datë 17.1.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 4.11.2014, është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me numër identifikimi (NUIS) L42304017T.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Konstatohet se shoqëria "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" "c"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e"), është plotësuar pjesërisht;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d"), është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo të përcjellë jo në formën e parashikuar nga rregullorja, e që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 2,

- germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë),

- do t'i kërkohet shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimin e Gjykatës dhe të Prokurorisë për gjendjen gjyqësorë të përfaqësueses ligjore të shoqërisë.

Nenin 9, pika 4.8,

- germa "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie),

- shoqëria ka deklaruar të njëjtin kapital financiar për qëllime të aplikimeve për rinovimin e licencës së tregtimit dhe të furnizimit. Do t'i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e secilës veprimtari më vete,

- germa "c" (lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur),

- Shoqëria në plotësim të kësaj kërkesë të rregullores ka listuar disa data kontratash, por pa të dhënat përkatëse të këtyre kontratave.

Për sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

- Rezulton se shoqëria aplikuese nuk është debitore sa iu përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 276, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 37, datë 18.3.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 19.3.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti